



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Tiranë, më 25.1.2022

*Dokument parlamentar*

*Komision përgjegjës*

**R A P O R T**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), DHE AGJENCISË FRANCEZE PËR ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “POLITIKA PËR MBËSHTETJEN E REFORMËS NË SEKTORIN ENERGETIK NË SHQIPËRI”**

**I. Hyrje**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 25.01.2022, mori në shqyrtim Projektligji, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Shpresa Marnoj.

Për të prezantuar aktin normativ në emër të Qeverisë, ishin të pranishëm:

*Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:* Znj. Delina Ibrahimaj Ministre si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

*Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:* Z. Ilir Bejtja Zv. Ministër

## **II. Baza ligjore Kushtetuese**

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ai, bazohet në nenet 78, 83 pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

Marrëveshja kuadër e huas është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.518, datë 18.9.2021, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve.

## **III. Qëllimi, përshkrimi i programit dhe përmbajtja e projektligjit.**

### ***Qëllimi i projektligjit:***

Qëllimi i projektligjit, është ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës së Francës i jep Republikës së Shqipërisë një kredi të butë, për të përmirësuar proceset e reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipëri në shumën maksimale totale në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro.

Plani i Bashkëfinancimit për këtë projekt do të jetë AFD 50 milionë Euro dhe KfË 100 milionë Euro.

Përmes VKM nr.742, datë 12.12.2018, “Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri”, i miratuar bazuar në memorandumit të mirëkuptimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, KfË dhe AFD-së (2018), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë aktualisht po implementon planin strategjik për reformimin e sektorit të energjisë, plan ky që parashikon një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar, sipas modelit të Bashkimit Evropian, i cili bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm, duke drejtuar reformën e sektorit të energjisë në përputhje me udhërrëfyesin (*roadmap*), që parashikon plotësimin me sukses të 11 elementeve të reformës në fundvitin 2020 dhe vazhdimin e 7 elementeve të tjera në fundvitin 2021. Nëpërmjet këtij programi synohet ndër të tjera:

- Konsolidimi i ndarjes së OSHEE-së - Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

- Funksionimi i Bursës së Energjisë (APEX);
- Hapja graduale e tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues të energjisë.

### ***Përmbajtja:***

Projektligji përbëhet nga 2 nene gjithsej.

- Në nenin 1, parashikohet ratifikimi i ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
- Në nenin 2 parashikohet hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Marrëveshja në vetvete përbëhet nga 18 pika gjithsej ku secila pikë, ndahet në disa nënpika dhe nga 12 skedule, si pjesë përbërëse e saj dhe konkretisht:

- Skeduli 1A – përkufizimet
- Skeduli 1B – interpretimi
- Skeduli 2 -përshkrimi i programit
- Skeduli 3A - plani i financimit
- Skeduli 3B - skema e monitorimit
- Skeduli 4 - kushtet pararendëse
- Skeduli 5A - formulari i kërkesës për disbursim
- Skeduli 5B - formulari i konfirmimit të disbursimit dhe normës
- Skeduli 5C - formulari i kërkesës së konvertimit të normës
- Skeduli 5D - formulari i konfirmimit të konvertimit të normës
- Skeduli 6 - informacione që mund të publikohen në faqen e internetit të qeverisë franceze dhe faqen e internetit të huadhënësit
- Skeduli 7 – plani i angazhimit mjedisor dhe social

### ***IV. Institucionet zbatuese***

Për zbatimin e aktit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## **V. Efektet Financiare**

Termat financiarë të marrëveshjes së huas paraqiten si më poshtë:

Shuma:	50,000,000 euro;
Interesi:	euribor 6-mujor + 1.35%;
Komision angazhimi:	0,25 % në vit;
Afati i ripagimit:	12 vjet;
Periudhë pa pagesë principali:	3 vjet;
Tarifë menaxhimi:	0.75%

Zbatimi i këtij projekti në këtë fazë nuk do të ketë efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit.

## **VI. Shqyrtimi i aktit normativ në komision.**

Përqafësuesit e Qeverisë bënë një prezantim të projektligjit, duke shpjeguar për komisionin, qëllimin e marrëveshjes, dhe të programit si dhe evidentuan termat financiarë të huasë.

Relatori i Komisionit, në fjalën e shpjegoi se me qëllim mbështetjen e Shqipërisë në zbatimin e një reforme të plotë në sektorin e energjisë, KfË-ja dhe AFD-ja japin një Hua të Bazuar në Politika (PBL), disbursimi i të cilës do të bazohet në monitorimin e zbatimit të Elementeve të Reformës së Politikave (PRE).

Objektivat e Huasë së Bazuar në Politika PBL-së sipas marrëveshjes synojnë:

- Ti krijojë mundësi Qeverisë së Shqipërisë, për të arritur e realizuar angazhimin e saj ndërkombëtar në lidhje me reformën në sektorin e energjisë;
- Të mbështesë Qeverinë Shqiptare në krijimin e një mjedisi tregu në kuadër të sektorit shqiptar të energjisë, i cili bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare, ka vlerën më të mirë për parane për shoqërinë shqiptare.

Huaja e Bazuar në Politika PBL strukturohet në dy faza:

- Faza e parë, konsiston në dhënien e transhit të parë në kohën e duhur që të mund të shqyrtohet më pas në buxhet me parakushtin për plotësimin në nivel të përshtatshëm të detyrimeve të miratuara;

- Faza e dytë, do të pasojë menjehere fazën e parë me disbursimin e trashit të dytë, në varësi të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Matricën e Stimulit për fazën e dytë.

Duhet theksuar fakti se huaja e akorduar përmes kësaj marrëveshje nga AFD-ja, në shumën 50 000 000 euro, për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik - faza 1, është e lidhur me plotësimin e 11 elementeve të reformës së energjisë në nivel të kënaqshëm, siç janë parashikuar në Skedulën 2 të marrëveshjes dhe që përmbledhtazi konsistojnë në: Marrëveshjen për shumat e papaguara dhe përmirësimi i moralit për pagimin e subjekteve publike; Ndarja dhe ristrukturimi i OSHEE; Zbatimi i hapjes së tregut dhe derregullimi i çmimeve; Krijimi i Bursës së energjisë; Zbatimi i mekanizmit dhe rregullave balancuese të bazuar në treg; Krijimi i RES-it dhe transformimi i Tarifave Mbështetëse (Feed-in); Miratimi i procesit të matjes dhe parashikimit; Ofertimi konkurrues për kapacitetet gjeneruese të energjisë së rinovueshme; Miratimi dhe zbatimi i Skemës për Mbështetje Sociale; Finalizohen aktet dytësore/nënligjore në përputhje me acquis të EnC; dhe Rritja e kompetencave dhe pavarësisë së ERE:

Marrëveshja ka parashikuar gjithashtu ndër të tjera edhe një skemë monitorimi. Për këtë qëllim KfE-ja, në emër të qeverisë gjermane, dhe AFD-ja, në emër të Qeverisë franceze, po krijojnë një instrument huadhënës, disbursimi i të cilit do të bazohet në monitorimin e zbatimit të elementeve të reformës së politikave (PRE) të përcaktuara në Udhërrëfyesin për këtë qëllim.

Përfaqësuesit e Qeverisë, iu përgjigjën dhe dhanë shpjegimet e nevojshme për të gjitha pyetjet dhe komentet e ngritura nga anëtarët e komisionit.

## ***VII. Përfundime***

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat duke vlerësuar se projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi si dhe duke vlerësuar se ratifikimi i marrëveshjes së huas, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri, do të mundësojë përmirësimin e proceseve të reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipëri, me votat pro të shumicës së anëtarëve të komisionit të pranishëm, e miratoi projektligjin, në parim, nën për nën dhe në tërësi.

**RELATOR**

**Shpresa MARNOJ**

**KRYETAR**

**Eduard SHALSI**